



Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

BULETINI ELEKTRONIK **E-MAPAS** NR.53

TË DREJTAT NGA ANËTARSIMI NË SHTYLLËN
E DYTË DHE PAGESA E PENSIONEVE

PRILL VITI 2025

FINANCIMI KAPITAL I DETYRUESHËM I SIGURIMIT PENSIONAL – SHTYLLA E DYTË

Cilët persona janë anëtarë të fondit të detyrueshëm pensional

Anëtar i fondit të detyrueshëm pensional është i siguruari i cili për herë të parë anëtarësohet në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invaliditor pas 1 janarit të vitit 2019 dhe në datën e anëtarësimit është më i ri se 40 vjet.

Si bëhesh anëtar i fondit të detyrueshëm pensional?

I siguruari mund të bëhet anëtar i një fondi të detyrueshëm pensional në dy mënyra:

- 1) duke nënshkruar kontratë për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional
- 2) me shpërndarje në një fond të detyrueshëm pensional nëpërmjet zgjedhjes së rastësishme

Para se të vendosni në cilin fond të detyrueshëm pensional do të anëtarësoheni, bisedoni me agjentët e shoqërive pensionale dhe kërkon legjitimacioni e agjentit me të cilin po bisedoni.

Për të kontaktuar një agjent, duhet t'u drejtoheni shoqërive pensionale ose bashkëpunëtorëve të tyre afaristë.

Nënshkruani kontratë anëtarësimi me fondin e detyrueshëm pensional që keni zgjedhur dhe plotësoni me kujdes të dhënat në kontratë. Të dhënat e kontaktit nga kontrata do të përdoren për dërgimin e raporteve të rregullta për kursimet tuaja në adresën tuaj të kontaktit.

Shoqëritë pensionale janë të detyruara të kujdesen për anëtarët e tyre nëpërmjet investimit të vazhdueshëm të mjeteve të tyre dhe nëpërmjet informimit të rregullt të anëtarëve për gjendjen e llogarive dhe portofolit të fondit pensional.

Përzgjedhja e fondit të obligueshëm pensional

Çdo i punësuar ka të drejtë të bëjë një zgjedhje personale (brenda tre muajve nga punësimi i parë) se me cilën shoqëri pensionale do të lidhë kontratë anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional.

Aktualisht ekzistojnë tri shoqëri pensionale që menaxhojnë secila nga një fond të detyrueshëm pensional:

1. Shoqëria pensionale Sava SHA Shkup rr. Dimçe Mirçev nr. 20 Shkup, tel. 02-15-500, www.sava-penzisko.mk
2. KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup rr. Mitropolit Teodosij Golloganov nr. 6 Shkup tel. 02-3243-777, www.kbprvo.mk
3. Shoqëria pensionale Trigllav SHA Shkup bul. 8 Shtatori nr. 16 Shkup, tel. 02-5102-190, www.triglavpenzisko.mk

Për më shumë informacione mbi punën e tyre dhe përzgjedhjen më të lehtë midis shoqërive pensionale mund:

- T'i vizitoni faqet e tyre ueb;
- T'i shqyrtoni raportet e tyre financiare të punës, strategjitë investuese dhe të ardhurat e realizuara, si dhe kompensimet që i paguajnë;
- Të mësoni çfarë shërbimesh u ofrojnë anëtarëve të vet;
- Ta vizitoni ueb faqen e MAPAS: www.mapas.mk

Kalimi nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër

Nëse nuk jeni të kënaqur me shërbimet e shoqërisë që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional ku jeni anëtar, mund të kaloni në një fond tjetër të detyrueshëm pensional i cili menaxhohet nga një shoqëri tjetër pensionale.

Që të kaloni nga fondi ekzistues i detyrueshëm pensional ku jeni anëtar në një fond tjetër të detyrueshëm pensional i menaxhuar nga një shoqëri tjetër (fondi i ardhshëm i detyrueshëm pensional), duhet të nënshkruani kontratë kalimi me shoqërinë që menaxhon fondin e ardhshëm dhe të jepni deklaratë me pëlqimin për kalim.

Gjithashtu, nëse jeni anëtar për më pak se dy vite, duhet të paguani një tarifë prej 15 eurosh, ndërsa nëse jeni anëtar për më shumë se dy vite, kalimi është falas.

Kushtojini kujdes:

- Gjatë nënshkrimit të kontratës për anëtarësim, agjenti duhet të shpjegojë karakteristikat e financimit kapital të detyrueshëm të sigurimit pensional.
- Përditësimi i të dhënave bëhet nëpërmjet një formulari të veçantë dhe nuk përfshin marrëveshje anëtarësimi përkatësisht nuk kalohet në një fond tjetër të detyrueshëm pensional.
- Anëtarësimi në fond të detyrueshëm pensional nuk rinovohet.

PAGESA E PENSIONEVE

Çdo anëtar duhet të informohet se ka llogarinë e vet individuale ku evidentohen mjetet e tij.

Me rrogën e parë fitohen edhe të drejtat e kursimit pensional dhe nevojitet që anëtarët të informohen në kohë mbi gjendjen në llogarinë e vet pensionale që ta planifikojnë më mirë të ardhmen, kurse nëpërmjet kësaj edhe pensionin.

1. Çfarë është pensioni?

Pensioni është burimi themelor i të ardhurave në pleqëri. Njeriu punon dhe merr rrogë kur është i ri dhe duhet të kursejë që të ketë mjete në pleqëri.

2. Kur anëtarët e fondeve të obligueshme pensionale realizojnë të drejtën për pension vjetërsie nga shtylla e dytë?

Në moshën 64-vjeçare për meshkuj, përkatësisht 62-vjeçare për femra, minimum 15 vjet përvojë pune.

3. Cilat janë llojet themelore të pagimit të pensioneve nga shtylla e dytë?

Llojet kryesore të pagesave të pensioneve nga sistemet e kapitalizuara me kontribute të përcaktuara janë tërheqjet e programuara, anuitetet dhe kombinimi i tyre.

- Tërheqja e programuar është një lloj pagese pensioni ose kompensimi pensional që shoqëria pensionale e paguan çdo muaj deri në fund të jetës ose deri sa të ketë mjete në llogarinë e anëtarit të fondit pensional.
- Shuma e tërheqjes së programuar llogaritet për herë të parë në momentin e realizimit të pensionit ose kompensimit pensional dhe rillogaritet çdo 12 muaj nga shoqëria pensionale.
- Anuiteti përfaqëson një seri pagesash të rregullta periodike që paguhen për një periudhë të përcaktuar paraprakisht (një numër i paracaktuar vitesh) ose deri sa përfituesi të jetë gjallë. Anuitetet paguhen nga një shoqëri sigurimi jete, çdo muaj, deri në fund të periudhës së përcaktuar ose deri në fund të jetës së pensionistit.

4. Si zhvillohet procedura e realizimit të së drejtës të pensionit të vjetërsisë nga shtylla e dytë?

- Anëtar i fondit pensional paraqet kërkesë për realizimin e të drejtës për pension vjetërsie në Fondin e SPIMV-së. Më pas, Fondi i SPIMV-së i dërgon kopje të vendimit të marrë, me të cilin i njihet ose nuk i njihet e drejta për pension vjetërsie, shoqërisë pensionale që menaxhon me fondin pensional ku është anëtar paraqitësi i kërkesës.
- Anëtar i fondit pensional paraqet kërkesë të shoqëria pensionale, e cila në emër të tij nis procesin e kotimit në Qendrën për Kotim. Në kërkesë, anëtar i fondit pensional përcakton se cilat lloje të pagesave pensionale dëshiron të përfshihen në kotim.
- Brenda pesë ditëve nga pranimi i kërkesës, shoqëria pensionale është e detyruar të paraqesë kërkesë për kotim në Qendrën për Kotim me numrin identifikues të kotimit dhe të dhënat e mëposhtme: shuma e mjeteve në llogarinë individuale, gjinia dhe data e lindjes së anëtarit të fondit pensional dhe llojet e pagesave pensionale.
- Më pas, shoqëritë pensionale paraqesin ofertat e tyre brenda pesë ditëve nga kërkesa për kotim në Qendrën për Kotim.
- Qendra për Kotim i dërgon shoqërisë pensionale tabelë përmbledhëse me të gjitha ofertat e pranuar për anëtarin e fondit pensional.
- Shoqëria pensionale ia dorëzon tabelën përmbledhëse me të gjitha ofertat anëtarit të fondit pensional, i cili brenda një periudhe prej 30 ditësh – sa zgjasin ofertat – mund të zgjedhë një ofertë.
- Pas përzgjedhjes përfundimtare të ofertës, anëtar duhet të nënshkruajë kontratën përkatëse, varësisht nga mënyra e zgjedhur e pagesës së pensionit nga shtylla e dytë dhe institucionit të përzgjedhur që do të bëjë pagesën.

5. Si realizohet e drejta e vetëm nga shtylla e dytë?

Anëtar i fondit pensional, i cili nuk ka realizuar të drejtën për pension vjetërsie në Fondin e SPIMV-së për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore me mbushjen e 15 viteve të stazhit, paraqet kërkesën për realizimin e të drejtës për pension vetëm nga shtylla e dytë në shoqërinë pensionale që menaxhon fondin pensional ku është anëtar.

Kërkesa për realizimin e të drejtës për pension vetëm nga shtylla e dytë paraqitet pas mbushjes 65 vjet. Së bashku me kërkesën, anëtar dorëzon edhe vërtetim të lëshuar nga Fondi i PSIMV-it që konfirmon se nuk i është njohur e drejta për pension për shkak të mosplotësimit të kushteve lidhur me kohëzgjatjen e stazhit pensional, si dhe një deklaratë të noterizuar ku ai heq dorë nga e drejta për pension nga shtylla e parë dhe nga e drejta për shumën minimale të pensionit.

”

"Pensionimi është një liri e merituar, kohë e mirë për të jetuar sipas rregullave tuaja."

Bruce Lermont

”

"Njeriu që i njeh të drejtat e veta është njeri që di si të jetojë i lirë."

Nelson Mandela



PJESËMARRJA E PËRFAQËSUESVE TË MAPAS-IT NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE PËR REFORMËN E SISTEMIT PENSIONAL NË SHQIPËRI

Më 5 shkurt 2025, përfaqësues nga Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional morën pjesë në konferencën ndërkombëtare “Reformimi i sistemit pensional në Shqipëri”, që u mbajt në Tiranë. Konferenca u organizua nga Banka Botërore dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të Shqipërisë.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



KOMITETI PËR STABILITET FINANCIAR E MIRATOI RAPORTIN VJETOR: SISTEMI FINANCIAR ËSHTË STABIL

Sistemi financiar edhe mandej është stabil, kurse rreziqet janë në nivel mesatar. Ky është përfundimi i përgjithshëm në Raportin vjetor të Komitetit për stabilitet financiar për vitin 2024, të cilin Komiteti e miratoi në mbledhjen e tij të fundit.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



FILLOI SHËNIMI I JAVËS GLOBALE TË PARASË 2025: “MENDO PARA SE TË “NDJEKËSH”, PËR SIGURINË E PARAVE TËNDE NË TË ARDHMEN!”

Fillimi i shënimit të Javës Globale të Parasë u shënua me nënshkrimin e sotëm të Memorandumit për bashkëpunim nga drejtoresha e Byrosë për zhvillimin e arsimit, Millka Trimçevska dhe kryetari i Agjencisë për mbikëqyrjen të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS, Maksud Ali, duke krijuar një partneritet strategjik për promovimin e shkrim-leximit dhe edukimit financiar në arsim.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



TAKIM PUNE I DREJTORIT TË FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR, MEMOV ME PËRFAQËSUES TË MAPAS DHE SHOQËRIVE PËR MENAXHIMIN E FONDEVE PENSIONALE TË DETYRUESHME DHE VULLNETARE



Drejtori i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Nikolla Memov, u takua me përfaqësuesit e MAPAS, Darko Sazdov dhe Mentor Jakupi, anëtarë të Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë, si dhe me kryetarët e Këshilleve Drejtuese të shoqërive pensionale private: KB Shoqëria e parë pensionale, Shoqëria pensionale Sava dhe Shoqëria pensionale Triglav, Vesna Stojanovska, Snezhana Stankoviç dhe Tihomir Petreski.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



Në përputhje me dispozitat strategjike për përforcimin e integritetit në institucionet publike, Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS) e konfirmon vendosmërinë e vet për mbajtjen e standardeve të larta etike, transparencës dhe përgjegjësisë në punën e vet.

Për më shumë informacione vizitoni **linkun** e mëposhtëm.



KENI PYETJE OSE ANKESA?
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në
contact@mapas.mk

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: (02) 3224 229
www.mapas.mk

